

PACIENTI DHE KUJDESTARI KËSHILLI PËR CILËSINË NË ONKOLOGJË (PATIENT AND CAREGIVER ONCOLOGY QUALITY COUNCIL, POQC)

Konsorciumi për Cilësinë në Onkologji në Miçigan (Michigan Oncology Quality Consortium, MOQC) është një grup i krijuar në vitin 2009, qëllimi i të cilit është të përmirësojë cilësinë e kujdesit që marrin pacientët e diagnostikuar me kancer në mbarë shtetin. MOQC mbështetet nga Blue Cross Blue Shield of Michigan (BCBSM) dhe puna e tij koordinohet në Universitetin e Miçiganit (University of Michigan). MOQC fokusohet tek të gjithë pacientët e diagnostikuar me kancer, veçanërisht ata që marrin kimioterapi, me ose pa sigurim.

HISTORIKU

MOQC formoi POQC për të rritur rolin e pacientëve, familjarëve apo kujdestarëve të tyre në punën e Konsorciumit tonë. Anëtarët e POQC mbështesin komitetin tonë drejtues dhe praktikën tona duke udhëhequr zhvillimin e projekteve të reja dhe duke ndarë punën tonë me komunitetin dhe grupet e tjera të interesuara. Ne jemi shumë të interesuar që të kemi pacientë dhe kujdestarë të cilët përfaqësojnë grupet e pakicave, duke përfshirë ata pambuluar mjaftueshëm me kujdes shëndetësor dhe ata që hasin ose kanë hasur vështirësi në aksesimin e sistemit të kujdesit shëndetësor.

NJË KËSHILLUES I MIRË PËR PACIENTIN OSE KUJDESTARIN

- Ka përvojë personale me kancerin si pacient ose
- Është i gatshëm të ndajë informacione nga përvoja ose perspektiva e tij
- Është në gjendje të flasë dhe të funksionojë si pjesë e një ekipi brenda një mjedisi të sigurt grupi
- Punon në mënyrë efektive me njerëz me prejardhje të ndryshme
- Ka akses në një kompjuter dhe në internet (Google Chrome si shfletues)
- Përdor emailin për të marrë dokumente, për të dërguar mesazhe dhe për të konfirmuar pjesëmarrjen dhe marrjen e informacionit
- Kupton dhe mund të menaxhojë programe bazike të Microsoft për modifikime të vogla të dokumenteve

ÇFARË TË PRISNI SI NJË ANËTAR I POQC

- Të kontribuoni 1-4 orë në muaj në aktivitetet në distancë të lidhura me MOQC, si për shembull:
 - Të shqyrtoni përmbajtje në internet ose dokumente dhe të bëni komente
 - Të merrni pjesë në 1-3 takime virtuale 1-orëshe nëpërmjet Zoom (kërkohet përparim minimal)
 - T'i ofroni mendime dhe komente MOQC-së ose praktika për tema të caktuara
- Të merrni pjesë në grupet e punës për përmirësim me në qendër temat e vetidentifikuara nga POQC
- Të komunikoni me Qendrën e Koordinimit të MOQC (MOQC Coordinating Center) nëse nuk mund të përfundoni apo përmbushni një marrëveshje

Anëtarët e Këshillit të Pacientëve dhe Kujdestarëve për Cilësi në Onkologji kompensohen për kohën e takimeve ballë për ballë dhe virtuale, si dhe për shpenzimet e lidhura me udhëtimet e bëra për takimet ballë për ballë.

PERSONI I KONTAKTIT

Vanessa Aron, menaxhere projekti
varon@moqc.org • 734-615-1796



Nonprofit corporations and independent licensees
of the Blue Cross and Blue Shield Association